



Datë: 05.03.2026
Numër Protokolli: 1156/2026

A.nr.70/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani -kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.70/2026, të datës, 23.01.2026 të parashtruar nga ankuesja N.H, kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa A.nr.70/2026, e datës 23.01.2026, e parashtruar nga ankuesja N.H.
- II. Mbetet në fuqi** Njoftimi i datës 26.12.2025 i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme për shpalljen e rezultateve përfundimtare.

A r s y e t i m

Ankuesja, N.H(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), më datë 23.01.2026 ka parashtruar ankesë, me numër protokolli 360/2026 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit sipas konkursit me numër reference RN00018667, për pozitën “*Zyrtar për Regjistrimin Civil*”, të shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar Këshilli*), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit më datë 29.01.2026 në MPB, ndërsa Këshilli më datë 12.02.2026 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 70/2026, të datës 23.01.2026, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për parashtrimin e ankesës të datës 23.01.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 29.01.2026; Lista me kandidatët fitues me numër protokolli Nr.2398, të datës 26.12.2025; Kopjen e letërnjoftimit; Njoftim për pranimin e aplikacionit, të datës 07.11.2025; Njoftim për test me shkrim, të datës 14.11.2025; Njoftimi përfundimtar për test me shkrim, i datës 21.11.2025; Njoftim për rezultatet përfundimtare, i datës 26.12.2025; Përgjigje në ankesë e datës 12.02.2026, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura nga organi i punësimit; Konkursi me numër reference RN00018667, i datës 15.09.2025; Vendim për emërimin e komisionit të pranimin, me numër Nr.75/2025, të datës 11.11.2025; Lista e aplikantëve (*aprovuar dhe refuzuar*); Njoftim me numër protokolli Nr.2076, i datës 07.11.2025; Njoftim i datës 14.11.2025; Njoftim me numër protokolli Nr.2200, i datës 25.11.2025; Formularët e vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatët në intervistë, të datës 01.12.2025; Aplikacioni me datë aplikimi 29.09.2025, të kandidatës I.H, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi 25.09.2025, të kandidatës N.H, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Akt emërimi i B.S me numër protokolli Nr.03-112, i datës 13.10.2011; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit i F.K, i datës 22.08.2016; Akt emërimi i A.B, me numër DRAPSH/ARC-2/13, i datës 31.01.2013; Akt emërimi i R.G, me numër Nr.ref: QPD/ARC-01-2020, i datës 01.10.2020; Akt emërimi i R.L, me numër DRAPSH/ARC-6/13, i datës 31.01.2013; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Testi individual i datës 17.11.2025.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankueses është ***e pabazuar***, sepse:

Nga analizimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Ministria e Punëve të Brendshme, më datë 15.09.2025, ka shpallur Konkursin publik me numër Reference RN00018667, gjegjësisht për pozitën e punës, “*Zyrtar për Regjistrimin Civil*”, me afat për aplikimi nga data 16.09.2025 deri më datë 15.10.2025.

Tutje, bazuar në shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 327 kandidatë, të cilët kriteret i kanë plotësuar 183 kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesja, e cila i është nënshtruar testimit me shkrim të kësaj procedure rekrutimi, mirëpo ka arritur të marr vetëm 46.6 pikë, të cilat nuk ka qenë të mjaftueshme për të kaluar testin me shkrim nga 50 pikë sa është e nevojshme për të vazhduar në procedurën e rekrutimit, respektivisht intervistës me gojë, sikurse përcaktohet me dispozitat e aplikuara nga Rregullore Nr. 15/2023 Për Procedurën e Pranimin në Shërbimin Civil, neni 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: “*2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë.*”, ndërsa sipas listës përfundimtare të kandidatëve kandidatja I.H është renditur e para në këtë listë me gjithsejtë 84.6 pikë, ashtu që sipas Njoftimit të datës 26.12.2025 të renditjes përfundimtare të kandidatëve të Divizionit të Burimeve Njerëzore në organin përkatës të punësimit, rezulton se kandidate fituese është kandidatja I.H e cila ka marr më shumë pikë, gjithsejtë 84.6 pike prej të cilave 62.8 në testin me shkrim, ndërsa 21.8 në intervistën me gojë.

Ankuesja, e pa kënaqur me rezultatet përfundimtare të për kandidatët e suksesshëm, në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se procedura e rekrutimit është përcjellë me shkelje procedurale dhe ligjore, dhe se ka mungesë të elementeve thelbësore të aktit administrativ respektivisht në këtë raste Njoftimit përfundimtar për kandidatin e përzgjedhur pasi që e njëjta pretendon se njoftimi për kandidatin e përzgjedhur nuk ka numër të aktit nuk është i vulosur nuk është i protokolluar dhe se i njëjti është akt i pa plote, andaj e njëjta kërkon që të bëhet rishpallja e këtij konkursi.

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor, lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e Konkursit me numër reference RN00018667 për pozitën e kategorisë Grupi i administrimit të përgjithshëm, profesional 2, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit, kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë **Arsimimi i kërkuar: Diplomën arsimit të lartë e nivelit të parë Bachelor ne Arsim i larte i paspecifikuar, ; Përvoja e punës e kërkuar: Së paku në vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës, nga rrjedh se kërkesat e përgjithshme formale të cekura si më lartë janë vendosur në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përkatësisht Shtojcës Nr.1/6 lidhur me përshkrimin e përgjithshëm të punës për Profesional 2 si dhe katalogun e vendeve të punës në shërbimin civil.**

Po ashtu, Kolegji i Këshillit, në kontest të shqyrtimit të kësaj procedure rekrutimit dhe duke u bazuar në dispozitat e sipër theksuara ligjore, ka analizuar Aplikacioni i kandidates I.H i datës 29.09.2025, nga i cili rezulton se e njëjta si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor e cila ka bashkangjitur Diplomën me Nr.119/13, të datës 08.07.2013 të Kolegjit Ilirja, me të cilin mori titullin Bachelor në Ekonomik-Banka dhe Financa dhe Kontabilitet, rrjedhimisht me këtë rast e njëjta dëshmon se ka plotësuar kriterin arsimor të përcaktuar me konkursin e lartë cekur, ndërsa sa i përket plotësimit të kriterit të përvojës një (1) vjeçare të punës profesionale, në bazë të Marrëveshjes për Shërbime të Veçanta të datës 17.07.2019 kandidatja e shpallur si fituese e kësaj procedura ka qenë e angazhuar në Ministrin e Punëve të Brendshme, në pozitën e Zyrtares për Pajisje me Dokumente, nga data 17.07.2019-16.10.2019, po ashtu posedon edhe vërtetimin e datës 10.01.2019 të lëshuar nga kompania Zena ShPK me të cilën vërtetohet se I.H ka qenë në marrëdhënia punë në këtë kompani nga data 01.05.2013 deri me 31.10.2018 e cila ka mbajtur pozitën e punës Zyrtare Administrative, si dhe ka sjell dëshmi që kjo përvojë e punës është mbështetur me pasqyrën e Trustit Pensional.

Mirëpo, Kolegji i Këshillit pas konstatimit të gjendjes faktike të pasqyruar si në arsyetimin e këtij vendimi, mori për bazë Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, me theks të veçantë nenit 20 paragrafi 2, ku është përcaktuar se: “2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtarë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues nga NjMBNj; dhe 2.3. një (1) nëpunës i kategorisë profesionale i fushës përkatëse.”, ndërsa përmes Vendimit Nr.752/25 të datës 11.11.2025 të UD Drejtorit Ekzekutiv të MPB është themeluar Komisioni i Pranimit prej 5 anëtarësh në këtë përbërje: R.L-Kryetar, i cili sipas Akt të Emërimit Nr.ARC-6/13 të datës 31.01.2013 mban pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Patente Shofer”, F.K-anëtar, i cili sipas Ndryshimit të Akt emërimit të datës 22.08.2016 mbanë pozitën “Udhëheqës i Qendrës për Regjistrim të Automjeteve” në Obiliq, R.G -anëtar, i cili sipas akt emërimit me numër ARC-01-2020 të datës 01.10.2020 mbanë pozitën e punës “Udhëheqës i Qendrës për Pajisje me Dokumente”, B.S- anëtare e cila sipas akt emërimit të datës

13.10.2011 mbanë pozitën “Zyrtare e Larte e Personelit”, A.B- anëtar i cili sipas Akt emërimit me numër ARC-0/13 te datës 31.01.2013 mbanë pozitën e punës Nëpunës administrativ, nga rrjedh se Komisioni i Pranimit është themeluar në pajtueshmëri me paragrafi 2, neni 20 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil dhe neni 40 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, e cila pretendon se njoftimi përfundimtar për kandidatin e përzgjedhur, si akt administrative i mungojnë elementet thelbësore të aktit, kolegji i këshillit analizoj Njoftimin e datës 26.12.2025 i cili njoftim duket shumë i qartë pasi që i njëjti ka datën e publikimit vulën e protokollit se bashku me numrin rendor të protokollit si dhe këshillën juridike, andaj ky pretendim nuk është i bazuar, po ashtu duke e pasur parasysh se ankuesja në testin me shkrim ka arritur 46.6 pike duke mos pasur mundësi të vazhdoj tutje në intervistën me goje, për rrjedhojë e njëjta nuk ka arritur ta argumentojë faktin me asnjë provë se ka pasur ndonjë shkelje apo i është cenuar të njëjtës ndonjë e drejtë në këtë procedurë të rekrutimit.

Prandaj, duke u bazuar në konstatimet si më sipër, Kolegji i Këshillit, konstaton se meqenëse në asnjë pretendim nuk u gjet se ankuesja ka të drejtë, respektivisht pretendimi i saj është i pabazuara, prandaj u vendos si në diapozitivin e këtij vendimi, ndërsa akti i kontestuar, Njoftimi i datës 26.12.2025, i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, u la në fuqi, ngase procedura e rekrutimit për pozitën e punës, “Zyrtar për Regjistrimin Civil” me Reference RN00018667 është zhvilluar në pajtueshmëri me dispozita e aplikuara nga neni 7 paragrafi 1 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “1. Pranimi në detyrë i nëpunëses/it civil, nëpunëses/it së shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it së artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknik dhe mbështetës, bazohet në parimin e meritës, e mundësive të barabarta, profesionalizmit dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë gjinor dhe të komuniteteve, përmes një procedure të hapur dhe konkurruese”.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 , Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.NR.70/2026

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses N.H;
- Udhëheqësit të Njesisë se Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së